



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

E. spokesperson@cec.gov.al, W. www.cec.org.al



Më 23.02.2018

Fjala e Kryetarit të KQZ-së, z. Klement Zguri në trajnimin për “Auditimin e raporteve të financimit të partive politike dhe të fushatës zgjedhore”, organizuar nga Zyra e Bashkimi Evropian dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë.

I nderuar z. Neukirch,

I nderuar z. Reed,

E nderuar zj. Stonestreet,

E nderuar zj. Kaçi,

Të nderuar pjesëmarrës,

Më lejoni të shpreh mirënjohjen time për Këshillin e Evropës dhe Bashkimin Evropian për punën e vazhdueshme dhe aktivitetet e njëpasnjëshme në lidhje me financimin e partive politike.

Një falenderim i veçantë shkon për z. Neukrich, i cili është angazhuar edhe personalisht që kjo tematikë me rëndësi, me ndikim të drejtpërdrejtë dhe sinjifikativ mbi cilësinë e proceseve zgjedhore, të marrë vëmendjen e duhur nga të gjithë aktorët dhe faktorët e përfshirë.

E kam thënë edhe më parë dhe do të vazhdoj ta theksoj që, **“Korrupsioni në financim është rruga pa shpëtim, është shit-blerje e votës, është abuzim me resurset shtetërore, është rrënim i paritetit në garë, është dhunim i vullnetit të lirë të zgjedhësve, është kapje e pushtetit politik nga krimi dhe antishteti. Korrupsioni në financim nuk është delikt kavalierësh, por është armiku më i egër i zgjedhjeve”**. Ndaj të gjithë ne duhet të japim kontributin tonë për të rritur transparencën e financimit të partive politike, si antidotin e korrupsionit zgjedhor.

Neni 9 i Kushtetutës së Shqipërisë parashikon që partitë politike duhet të organizohen në përputhje me parimet demokratike, dhe që burimet financiare e shpenzimet e tyre të bëhen kurdoherë publike. Ndërkohë që me ligjin mbi të drejtën e informimit, transparenca publike është bërë kriter vlerësimi dhe standard baze për çdo institucion publik, ku bëjnë pjesë edhe partitë politike, si organizata që kryejnë aktivitet kushtetues dhe kanë të përfshirë funksionarë publikë.

Është shumë e vështirë të fshehësh korrupsionin dhe praktikatat e gabuara në rast se publiku ka dijeni.

Megjithatë, partitë politike në Shqipëri nuk i publikojnë vetë deklaratimet financiare për publikun e gjerë, si dhe për anëtarët e tyre. I vetmi informacion është ai që mundëson Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe i publikuar në faqen zyrtare të internetit të KQZ. Pra, partitë politike vijojnë të jenë të mbyllura për publikun dhe hermetike për transparencën dhe llogaridhënien publike.

Në vendin tonë partitë politike e kanë mision fshehjen e të ardhruave dhe të shpenzimeve të realizuara prej tyre gjatë vitit kalendarik dhe gjatë vitit zgjedhor, por misioni i KQZ-së dhe i juaji si auditë kontabël është bërja transparencë financave të tyre.

Legjislacioni mbi partitë specifikon parime e standarde që lidhen me rregullat demokratike të funksionimit, por nuk ka krijuar mekanizma institucionalë të monitorimit të zbatimit të ligjit, përveç Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, i cili kontrollon vetë-deklarimet e partive politike nëpërmjet audituesve të liçensuar.

Ndryshimet e fundit ligjore kanë sjellë përmirësim të transparencës së financave të partive politike por jo transparencë të plotë.

Gjatë muajve të fundit kemi diskutuar gjërësisht për mënyrën sesi duhet të bëhet transparenca e financave të partive politike, kuadri aktual ligjor dhe ndryshimet që duhet të bëhen për të përmirësuar atë. Diklutime të cilat kanë konkluduar në domosdoshmërinë e harmonizimit të kuadrit ligjor; në domosdoshmërinë engritjes së strukturave të mbikqyrjes, monitorimit dhe kontrollit profesional e rezultativ të financave; në domosdoshmërinë e metodologjive të sakta, të përshtatshme dhe të kolaoduara të punës, si dhe në bindjen e gjithanëshme të ligjit, vetëdisplinës dhe vetëregullimit nga ana e partive politike.

KQZ prej shumë kohësh ka bashkëpunuar me ekspertët e Këshillit të Evropës dhe NDI për të gjetur praktikat më të mira dhe të përshtatshme për kushtet në të cilat ndodhet vendi ynë, sa i përket auditimit të financave të partive politike. Kemi punuar për hartimin e modeleve të standardizuara për raportet e financimit të fushatës zgjedhore, raportet e monitorimit të ekspertëve financiarë dhe raporte vjetore të partive politike.

Ndaj trajnimi i sotëm është një vlerë e shtuar e kësaj pune madhore që është bërë në këtë drejtim.

Sot, në plan të parë janë vendosur auditët e autorizuar, ata të cilët auditojnë partitë politike për fondet e përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe gjatë viteve zgjedhore.

Prezantimi i formateve të standartizuara mbi auditimin e financimit të partive politike dhe shkëmbimi i ideve dhe praktikave më të mira të kontrollit financiar do të ndikojnë në thellimin e njohurive ligjore dhe në zbatimin me efikasitet të ligjit duke çuar në rritjen e transparencës mbi financat e partive politike.

Faleminderit!

